



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:206437

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06903188

P.nr.124/2024

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA KLINË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurit L I nga P rr. „S Q”, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me aktauzën e PTH-së në Pejë me PP/II nr. 1736/2022 e dt. 06.10.2022 në bazë të nenit 357 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, dhe nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt.26.02.2025, maur këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur në ndërmjetësim Nd. nr. 2/2025 në mes të pandehurit, L I dhe palës dëmtuar B K nga P Rr. Shj”.

HUDHET AKTAKUZA: e Prokurorisë Themelore Pejë, me nr. PP/II. Nr. 1736/2022 e dt. 06.10.2022, për të pandehurin L I nga P rr. „S Q”, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, për shkak se, palët ne rastin konkret, në procedurën e ndërmjetësimit kanë arrit marrëveshje dhe pajtim në mes veti me nr. Nd.2/2025 me dt. 14.02.2025.

PUSHOHET: procedura penale në çështjen penale PP/II. 1736/2022 e dt. 06.10.2022, për të pandehurin L I.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë me nr. PP/II. Nr. 1736/2022 me dt. 06.10.2022, për të pandehurin L I nga P rr. „S Q”, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-së.

Në bazë të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokolli 01/66 i dt.29.01.2022, e ka referuar rastin për ndërmjetësim.

I pandehuri L I dhe pala e dëmtuar B K nga nga Prr. „S Q, kanë arritur marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit me Nd. nr.2/2025 e dt. 14.02.2025.

Prokuroria është njoftuar për marrëveshjen e ndërmjetësimit në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit të lartëcekur me dt. 20.02.2025.

Gjykata në bazë të nenit 15 të ligjit për ndërmjetësim të Kosovës e ka aprovuar marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim në mes të pandehurit, si dhe palës së dëmtuar, për shkak të arritjes së marrëveshje përmes procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata bazë të nenit 358 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, nenit 232 të KPPK-ës, nenit 2 paragraf 2, nenit 8 lidhur me nenin 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, udhëzuesit për lëndët e gjykatave të përshtatshme për ndërmjetësim i nxjerr nga këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër protokolli 01/66 i dt.29.01.202, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt. 26.02.2025 ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA KLINË
P.nr. 124/2024 dt, 26.02.2025

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankese në afat prej tre (8) dite drejtuar gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:206437
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06903188